



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Prishtinë, 26 maj 2022

Nga: Ymer Fejzullahu, Kryesues i Bordit të ZRRE-së

Për: Z. Kadri Kadriu, u.d, Kryeshef Ekzekutiv, KOSTT Sh.A

Z. Alpin Dogan, Drejtor Menaxhues, KEDS Sh.A


Kopje: Z. Ferat Shala, Kryetar i Komisionit për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti

Z. Artane Rizvanolli, Ministre e Ekonomisë

Z. Ismet Krasniqi, Sekretar i Kuvendit të Kosovës

Znj. Fëllënëza Xhelili, Drejtor i Departamentit për Çështje Rregullative, KOSTT Sh.A

Z. Bajram Neshati, Menaxher për Analiza dhe Raportime, KEDS Sh.A



Nr. 274122
Data. 26.05.22

Lënda: Inicimi i procesit të Shqyrtimit të Tretë Periodik Tarifor

Po ju drejtohem me qëllim të prezantimit të planit të Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) përkitazi me Shqyrtimin e Tretë Periodik për periudhën rregullative 2023-2027.

Zyra e Rregullatorit për Energji po fillon me Shqyrtimin e Tretë Periodik për tarifat shumëvjeçare (PR3) për të vendosur të Hyrat e Lejuara Maksimale (HLM) të të licencuarve të OST/OT dhe OSSH, për periudhën 1 prill 2023 deri më 31 mars 2027. HLM e tanishëm janë përcaktuar me Shqyrtimin e dytë Periodik të cilat vlejné deri më 31 mars 2023.

Në këtë proces të Shqyrtimit Periodik ZRRE do të shqyrtojë vlerat hyrëse që do të shfrytëzohen për të përcaktuar HLM, po ashtu ZRRE do të bëjë vlerësimin e kostove të operimit në mënyrë të detajuar për t'u siguruar se ato janë të arsyeshme dhe ofrojnë stimuj të adekuat për përmirësimin e efikasitetit. Ky shqyrtim do të fillojë me mbledhjen e të dhënave relevante nga të licencuarit. Analiza e ZRRE-së e këtyre të dhënave dhe propozimet e saj do të bëhen publike dhe do të konsultohen para se të bëhet ndonjë vendim.

ZRRE është e përkushtuar dhe kërkon përkrahjen tuaj që ky proces të zhvillohet brenda afateve të propozuara. Për të lehtësuar procesin, ZRRE është e gatshme të ofroj sqarime dhe konsultime përmes shkresave apo takimeve, kurdo që të jetë e nevojshme.

Me respekt,

Në emër të Bordit të ZRRE-së
Ymer Fejzullahu

